

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. 92 Prot.

Tiranë, 22 Dhjetor 2023

Federata Shqiptare e Basketbollit, në zbatim të Statutit të sajë, si dhe bazuar në ndarjen e informacionit nëpërmjet email-eve, datë 20 nëntor 2023 email i parë mbi datën dhe qytetin e organizimit të Asamblesë, datë 30 nëntor 2023 email i dytë nga Skeratari i Përgjithshëm mbi dokumentacionet e nevojshme për pjesëmarrje, si dhe datë 20 dhjetor 2023 kujtesë mbi pjesëmarrjen në Asamble, organizoi Asamblenë e Përgjithshme Vjetore më datë 22 dhjetor 2023.

Asambleja u drejtua nga Presidenti, z. Avni Ponari, me prezencë të anëtarëve të Komitetit Drejtues, znj. Migena Plasa, z. Juel Jarani, z. Klevis Kaso, znj. Edera Alibegaj, me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm, z. Franko Bushati, si dhe me përfaqësues nga 17 shoqata anëtare të FSHB-së, nga 24 shoqata anëtare në total, duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e Asamblesë, si më poshtë:

| Nr. | Shoqatat Anëtare të FSHB-së | Adresa | Personat perfaqesues ne Asamble |
|-----|---|---------|---|
| 1 | Shoqata e Basketbollit Vllaznia | Shkodër | Bledar Gjeçaj, Antonio Shabani, Roni Gjeçaj |
| 2 | Shoqata "Akademia Sportive Goga Basket" | Tiranë | Perikli Goga |
| 3 | Shoqata "Eagles Basket" | Tiranë | Ylli Ujka, Albert Ndreu |
| 4 | Shoqata "Galaktikët" | Tiranë | Klejda Osmani |
| 5 | Shoqata "Teuta Basket" | Durrës | Arqile Gorea, Napoleon Llalla |
| 6 | Shoqata "Marsi Basket" | Tiranë | Endi Lazimi |
| 7 | Shoqata "ABC" (Albanian Basketball Center) | Tiranë | Bruno Hoxha |
| 8 | Shoqata Sportive e Basketbollit Flamurtari | Vlorë | Elona Hasanaj |
| 9 | Shoqata e Basketbollit "Skënderbeu" | Korçë | Juxhin Çili, |
| 10 | Shoqata e Basketbollit "Apolonia" | Fier | Palion Zarka, Aldi Gërmau |
| 11 | Shoqata "Pro Basket Invaders" | Tiranë | Mikel Sërbo |
| 12 | Shoqata "Karaj Basket" | Tiranë | Erkand Karaj, Onaldo Ago |
| 13 | Shoqata "Basket F Tirana 20" | Tiranë | Roland Avrami |
| 14 | Shoqata e Vëzhguesve dhe Gjyqtarëve të Basketbollit | Tiranë | Arben Kasmi |
| 15 | Shoqata "Dinamo Basket" | Tiranë | Bujar Spaho |
| 16 | Shoqata "Fieri Basket 2008" | Fier | Hermjona Çuko |
| 17 | Shoqata "Partizani Basket" | Tiranë | Albi Greva, Erdal Borova, Anila Boshnjaku |





Shoqatat anëtare të cilat nuk u përfaqësuan në Asamble:

- 1 Shoqata "Studenti Basket"
- 2 Shoqata "Klubi i Basketbollit Elbasan Femra"
- 3 Shoqata "Vlora Basket"
- 4 Shoqata "Superior Basket"
- 5 Shoqata e Basketbollit "Permeti"
- 6 Shoqata "Kamza Basket"
- 7 Shoqata "Klubi i Basketbollit Tirana Meshkuj"


Asambleja e Përgjithshme u zhvillua sipas rendit të ditës:


1. Veprimtaritë basketbollistike FSHB-se 2023;
2. Plani i aktiviteteve kombëtare 2024;
3. Plani i aktiviteteve ndërkombëtare 2024;
4. Analiza Financiare e FSHB-së 2023;
5. Pranimin në parim të anëtarëve të rinj, mbështetur në nenin 5 të Statutit të FSHB-së, si dhe kërkesës së paraqitur nga shoqatat e interesuara për anetaresim, të cilat aktualisht marrin pjesë në veprimtarinë e FSHB-së, si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi Shoqatës | Adresa | Vendimi gjykatës | Përfaqësuesi në Asamble |
|-----|--|----------|--|-------------------------------|
| 1 | Shoqata Barleti | Tiranë | Nr.5454/3 - 20.05.2021 | Illia Kuro |
| 2 | Elite Basket | Tiranë | Nr. 6263 - 05.06.2019 | Ilir Canhasi |
| 3 | Leaders | Tiranë | Nr. 6489 - 02.06.2020 | - |
| 4 | Royal Basket | Tiranë | Nr. 6993 - 07.10.2022 | Elidon Beqo |
| 5 | Shoqëria "Akademia Basketbollit Durrës" (SHPK) | Durrës | 09.12.2022 - Qendra Kombëtare e Biznesit | Besim Dervishaj, Ondis Prifti |
| 6 | Skampa Basket Elbasan | Elbasan | Nr. 6633 - 09.02.2021 | Edmond Biçoku, Engjëll Spahiu |
| 7 | Pogradeci Basket | Pogradec | Nr. 7177 - 12.09.2023 | Klevis Cane |
| 8 | Juvenilja Basket Academy | Durrës | Nr. 7230 - 22.11.2023 | Francesco Vitobello |
| 9 | Tirana Basket | Tiranë | Nr. 5675/1 - 30.11.2022 | Alfred Cibaj |

6. Diskutim i hapur me pjesëmarrësit në Asamble lidhur me Analizën Vjetore 2023 si dhe çështje të tjera sipas interesimit nga pjesënarrësit. Ky diskutim u drejtua nga presidenti, z. Avni Ponari, ku u trajtuan specifika të ndryshme si më poshtë:

6.1 – Z. Albi Greva, përfaqësues i shoqatës Partizani Basket, shprehu nevojën e njohes më të mirë me materialet e Asamblesë së Përgjithshme në mënyrë që të trajtohen më në detaje sepcifikat e sajë, rritjen e ndikimit të FSHB-së për realizimin e ligjit të sponsorizimeve, realizimi i një strategjie për rekrutimin e gjyqtarëve të rinjë, si dhe marrjen në konsideratë të vështirësive ekonomike të shoqatave pjesëmarrëse në kampionatet kombëtare lidhur me ndryshime financiare në rregulloren e aktiviteteve kombëtare;





6.2 – Z. Albert Ndreu, përfaqësues i shoqatës Eagles Basket, shprehu nevojën e marrjes në konsideratë të interesit të ekipeve pjesëmarrëse në kampionatin kombëtar meshkuj lidhur me ndryshimet e ndërmarra për këtë kategori, duke mos i përgjithsuar me të gjitha shoqatat anëtare pasi nevojitet trajtim i veçantë sipas pjesëmarrjes, veçanërisht në ndryshimet e ndërmarra për sistemin e kampionatit, tarifat e transferimeve të lojtarëve të huaj dhe vendas, si dhe trajtimit financiar më të ulët për transferimet e lojtarëve që mbushin 18 vjeç në edicionin e parë të tyre në kategoritë të rritur;

6.3 – Z. Arqile Gorea, përfaqësues i shoqatës Teuta Basket, ri-theksoi marrjen e vendimeve për ndryshime në rregullore duke marrë në konsideratë mendimet e shoqatave sipas kategorive ku ato marrin pjesë, si dhe duhet treguar kujdes në kontrollin e gjyqtarëve duke ndëshkuar në raste të pa aftësisë apo veprimeve të njëanshme, të cilat dëmtojnë aktivitetin dhe investimin e shoqatave;



6.4 – Znj. Anila Boshnjaku, përfaqësuese e shoqatës Partizani Basket, shprehu se regjistrimi i ndeshjeve ka kosto për ekipet pjesëmarrëse në kampionatet kombëtare të rritur/a, si dhe nuk duhet të jetë e detyrueshme dërgimi i fotove pas ndeshjeve;

6.5 – Z. Erdal Borova, përfaqësues i shoqatës Partizani Basket, shprehu nevojën e funksionimit të drejtpërdrejtë të komisionit të gjyqtarëve, duke marrë ankimimet për ndeshjet, si dhe duke realizuar një plan strategjik të strukturuar për zhvillimin e gjyqtarëve si në shtim të numrit të tyre, po ashtu dhe në përmirsimin e aftësive të tyre.

Sa më sipër, z. Avni Ponari shprehu angazhimin e FSHB-së për të marrë në konsideratë të gjitha mendimet e anëtarëve të sajë, çdo përfaqësues i shoqatave anëtare mund të paraqitet në zyrat e FSHB-së për të parë veprimet financiare sipas nevojës së tyre për informacion, vendosjen për regjistrim fakultativ të ndeshjeve dhe heqjen e sanksjonit për mos dërgim të fotove pas ndeshjeve. Gjithashtu, z. Ponari dha arsyetimet përkatëse për vendimet e ndërmarra nga Komiteti Drejtues i FSHB-së lidhur me ndryshimet në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit, veçanërisht për ndryshimet në tarifat e transferimeve të lojtarëve vendas.

7. Z. Avni Ponari, bazuar në vendimin 11 të Komitetit Drejtues, vlerësoi me titullin "President Nderi" z. Gazmend Çaçi, z. Roland Avrami, z. Pjerin Bushati, si dhe z. Astrit Zaganjori; Gjithashtu, vlerësoi me pllakadë mirënjohje z. Klevis Kaso për asistencën në sigurimin e financimeve të disa aktiviteteve të FSHB-së, z. Enea Goga për mbështetjen nëpërmjet ambjenteve sportive të Akademisë "Goga Basket", si dhe z. Gerti Shima për karrierën basketbollistike.
8. Vendimarrja e Asamblesë për autorizimin e Presidentit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të FSHB-së për të nënshkruar Vendimin e Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme;

Avni Ponari
President

Franko Bushati
Sekretar i Përgjithshëm

